

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Muhamet Rexha, antarë, në çështjen juridike të paditësit E.N., nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson M.I., av. nga Ferizaj, kundër të paditurës “R.B.K” në Prishtinë, si pasardhës juridik i ish- B.A.K., për anulimin e vendimit për shkëputjen e kontratës së punës, përkitazi me kërkesën e të autorizuarit të paditësit për kthim në gjendje të mëparshme dhe revizionin e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr.118/2010, datë 16.09.2011, në seancën e mbajtur më 22.3.2016, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I.LEJOHET** kërkesa e paditësit E.N., nga Ferizaj, për kthim në gjendjen e mëparshme, **PRISHET** aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.333/2011 datë 21.01.2013.

**II.PRANOHET** si i bazuar revizioni i paditësit E.N., nga Ferizaj, ashtu që **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr.118/2010, datë 16.09.2011, mbetet në fuqi pjesa I e dispozitivit aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, CI.nr.32/2006, datë 14.10.2009, me të cilin është miratuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar vendimi i të paditurës, datë 10.11.2002, në bazë të të cilit në procedurën e rishqyrtimit është vërtetuar vendimi i shkallës së parë i datës 13.09.2002, me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës si dhe pjesa II e dispozitivit, që ka të bëjë me detyrimin e së paditurës që ta kthejë në punë paditësin në vendin e punës që i përgjigjet përgatitjes së tij profesionale.

**III** Pjesa II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale Prishtinë, CI.nr.32/2006, datë 14.10.2009, që ka të bëjë me njohjen e të gjitha të drejtave të paditësit nga marrëdhënia e punës

nga data 01.10.2002, deri në momentin e kthimit në punë, **PRISHET** dhe lënda i kthehet për rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

**IV** Pjesa III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale Prishtinë, CI.nr.32/2006, datë 14.10.2009, që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, mbetet e pasqyrtuar.

### **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac.nr.118/2010, datë 16.09.2011, është miratuar si e bazuar ankesa e të paditurës, kurse aktgjykimi i Gjykatës Komunale Prishtinë, C.I.nr.32/2006, datë 14.10.2009, është ndryshuar dhe është refuzuar kërkesëpadia e paditësit E.N., nga Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të anulohet si kundërligjor vendimi i të paditurës “R.B.K.” në Prishtinë, si pasardhës juridik i ish-B.A.K. Prishtinë, datë 10.11.2002, në bazë të të cilit, në procedurën e rishqyrtimit sipas kërkesës së paditësit, është vërtetuar vendimi i shkallës së parë, datë 13.09.2002, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditësit, si dhe pjesa e kërkesëpadisë që ka të bëjë me detyrimin e të paditurës që paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës i cili i përgjigjet përgatitjes së tij profesionale, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, duke filluar nga data 01.10.2002, deri në ditën e kthimit të tij në punë, si dhe pjesa e kërkesës që ka të bëjë me kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore si e pabazuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi e ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i gjykatës e shkallës së dytë të ndryshohet dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të lihet në fuqi.

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin Rev.nr.333/2011, datë 21.01.2013, ka hedhur poshtë revizionin e paditësit si të paraqitur pas afatit kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr.118/2010, datë 16.09.2011.

Kundër aktvendimit në fjalë, paditësi ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme, sepse i është përmbajtur afatit për paraqitje të revizionit, me propozimin që kërkesa të aprovohet dhe të lejohet kthimi në gjendje të mëparshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin CN.nr. 7/2013, datë 19.10.2013, ka lejuar kthimin në gjendjen e mëparshme dhe ka anuluar aktvendimin e vet dhe e ka pranuar revizionin e paditësit si të paraqitur brenda afatit, duke marrë vendim lidhur me të me pjesën II të dispozitivit.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me aktgjykimin nr. Ki 10/14, datë 26 qershor 2014, Nr. ref. AGJ 648/14, e ka pranuar si të bazuar kërkesën e të paditurës, duke konstatuar se aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, CN.nr.7/2013, datë 19 tetor 2013, është marrë me shkelje të nenit 31 (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një procese të rregullt ) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, për faktin se Gjykata Supreme e Kosovës nuk e ka njoftuar parashtruesin e kërkesës, këtu të paditurën, për ekzistimin e procedurës lidhur me kërkesën për kthimin në gjendje të mëparshme të parashtruar nga paditësi, kështu që e paditura nuk kishte pasur mundësi të parashtrrojë prova, pasi që rasti tashmë kishte përfunduar. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese e Kosovës e shpalli të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CN.nr.7/2013, datë 19 tetor 2013, kurse lëndën ia ktheu Gjykatës Supreme për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme ia dorëzoi të paditurës më 18.12 2015. E paditura nuk është deklaruar lidhur me kërkesën e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të propozimit të paditësit për kthim në gjendje të mëparshme në përputhje me nenin 133.2 të LPK, konstatoi:

Kërkesa është e bazuar.

Nga plikvoja e postës rezulton se i autorizuari i paditësit, avokati M.I., aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr. 118/2010, datë 16.09.2011, e ka pranuar më 01.10.2011 (data e nënshkrimit të fletë-dorëzuesit kur për herë të dytë aktgjykimi i është lënë në derë), ndërsa në fletë-kthesën që është nënshkruar nga i autorizuari gabimisht i paditësit është shënuar data e pranimit të aktgjykimit - më 03.09.2011. I autorizuari i paditësit revizionin e ka dorëzuar në Gjykatën Komunale Ferizaj përmes postës rekomande R.Nr. ... datë ... dhe për rrjedhojë, kjo Gjykatë vërtetoi se revizioni i paditësit është paraqitur brenda afatit ligjor prej 30 ditësh në kuptim të nenit 211 të LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi aprovoi propozimin e paditësit për kthim në gjendjen e mëparshme dhe prishi aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.333/2011, datë 21.01.2013, vendosi lidhur me revizionin e paditësit në kuptim të nenit 215 të LPK dhe konstatoi:

Revizioni është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar në ish-Shërbimin e Kontabilitetit Shoqëror - Filiali në Ferizaj, i cili institucion, pas luftës, është transformuar në autoritet të pagesave – APK, ndërsa ky, si i tillë, është shuar dhe të gjithë punonjësit e deriatëhershëm, bashkë me objektin dhe pajisjet, janë transferuar te Autoriteti Bankar i Kosovës. Nuk është kontestues fakti se Banka Amerikane, me rastin e marrjes me qira të objektit të BPK-ës, i ka pranuar edhe 220 ish-punëtorë të saj.

Paditësi, sipas kontratës së punësimit të datës 18 qershor 2002, ka qenë i punësuar te Banka Amerikane e Kosovës me kohë të pacaktuar, por edhe si subjekt shkarkimi nga puna sipas nenit 7 të kontratës. Me nenin 7 të kontratës janë përcaktuar 3 raste të mbarimit të kontratës: n rastin e parë, pa shkaktar të punësuarin dhe punëmarrësin, sipas njoftimit me shkrim një muaj përpara; në rastin e dytë, për shkelje të detyrave të punës, parashikuar nga neni 5 i Doracakut, datë 4 janar 2002 dhe në rastin e tretë, për shkak të shkeljeve të detyrave të punës, parashikuar nga neni 11 i Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2001/27.

Me njoftimin me shkrim të së paditurës, datë 13.09.2002, paditësi është njoftuar se i përfundon kontrata e punësimit, duke filluar nga data 13 shtator 2002, bazuar në nenin 1 të kontratës së punësimit, si rezultat i riorganizimit të degëve. Me të njëjtin njoftim e paditura ka shprehur mirënjohje dhe falënderim për angazhimin dhe punën e shkëlqyer të paditësit gjatë kohës së punësimit në Bankën Amerikane.

Kundër këtij njoftimi paditësi i ka paraqitur ankesë së paditurës më 30.10.2002. E paditura, me njoftimin (vendimin) datë 10.11.2002, konfirmon se pushimi i marrëdhënies së punës së paditësit është definitiv dhe, si arsye për largim, është ristrukturimi i Filialit në Ferizaj–zvogëlimi i numrit të punonjësve dhe për faktin se paditësi ka qenë i pranuar me kohë të caktuar, kurse gjatë punës provuese ka treguar rezultat të pakënaqshëm. Ndërkaq, në përgjigje të padisë dhe në seancën e mbajtur me datë 8.5.2008, e paditura e ka përmendur se si arsye të mosvazhdimin të kontratës mosnjohjen e gjuhës angleze nga ana e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, ka bërë administrimin e provave me dëgjimin e dëshmitarit N.D. dhe, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se e paditura, me rastin e shkëputjes së njëanshme të marrëdhënies së punës të paditësit, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 12.1 të Rregullores nr. 2001/27 të LTHPJ të Kosovës, prandaj e aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën e ankimit, ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë e ka marrë aktgjykimin kontestues në bazë të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, për faktin se paditësi ka pasur cilësinë e punonjësit me kohë të caktuar në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh, duke filluar prej dt.18.06.2002 deri më datë 18.9.2002, domethënë paditësit i ka pushuar marrëdhënia e punës me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit në pajtim me dispozitën e nenit 11.1 (d) të Ligjit Themelor të Punës të Kosovës, prandaj e ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale (neni 224.1 i LPK) në dëm të paditësit kur ka gjetur se kërkesëpadia e

paditësit është e pabazuar dhe, si të tillë, edhe e ka refuzuar. Vlerësimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë se paditësi ka pasur të lidhur me të paditurën një kontratë pune në kohëzgjatje 3 (tre) muajsh, duke filluar nga data 18.6.2002 deri më datë 18.9.2002 dhe, pas skadimit të kësaj kohe, paditësit i ka përfunduar kontrata e punës në mbështetje të dispozitës së nenit 11.1 të Ligjit Themelor të Punës të Kosovës, është i papranueshëm dhe në kundërshtim me vetë njoftimin për shkëputjen e kontratës së punës, datë 13.09.2002, në të cilin si arsye e përfundimit të kontratës së punës përmendet riorganizimit i degëve dhe, me këtë rast, e paditura ka shprehur mirënjohje dhe falënderim për angazhimin dhe punën e shkëlqyer të paditësit gjatë kohës së punësimit në Bankën Amerikane. Kjo do të thotë se gjykata e shkallës së dytë, në procedurën e marrjes së vendimit lidhur me ankesën e të paditurës, nuk i ka përfillur arsyet e vërteta të vëna në dukje në njoftimin për shkëputjen e kontratës së punës dhe në përgjigjen ndaj ankesës, duke mos e marrë fare për bazë faktin se në kontratën e punës thuhet se paditësi është pranuar në kohë të pacaktuar.

Për më tepër, kjo Gjykatë shton se neni 1 par 4 i kontratës së punës, datë 18 qershor 2002, nuk është në harmoni me dispozitën e nenit 10.1 të Ligjit Themelor të Punës të Kosovës, për faktin se punonjësi nuk mund të themelojë në të njëjtën kohë marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar dhe me mundësinë e përfundimit të kontratës pa arsye, me njoftim me shkrim një muaj përpara. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, neni 1 par 4 i kontratës së punës e përkufizon të drejtën e paditësit dhe përcakton kushte më pak të favorshme se ato të përcaktuar me dispozitën e nenit 10.1 të Ligjit Themelor të Punës të Kosovës dhe, si e tillë, është në kundërshtim edhe me dispozitën e nenit 10.4 të Ligjit Themelor të Punës të Kosovës, ku është parashikuar se kontrata e punës nuk përfshin dispozita që kufizojnë të drejtat e punonjësve ose që përcaktojnë kushte më pak të favorshme nga ato që përcaktohen me këtë rregullore dhe, sipas rastit, edhe me marrëveshjen kolektive.

Prandaj, në revizion theksohet me të drejtë se gjykata e shkallës së dytë e ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vlerësuar se atij t i është shkëputur kontrata e punës për shkak të skadimit të kohës së punësimit.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpapia e paditësit, lidhur me pjesën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit, është e bazuar për sa i përket anulimit të njoftimit të së paditurës mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditësit dhe kthimin e tij në punë dhe në detyrat e mëparshme të punës.

Gjykata e shkallës së parë ka përfunduar me të drejtë se paditësit i është shkëputur kontrata e punës në kundërshtim me nenin 12.1 të Ligjit Themelor të Punës të Kosovës, që parashikon se kontrata e punës mund të shkëputet nga punëdhënësi për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale të ndërmarrjes. Ndryshime të tilla paraqesin rastet kur punëdhënësi bën ndryshime në prodhim, programim, organizim, strukturë dhe teknologji, të cilat kërkojnë zvogëlim të numrit të punonjësve, kurse në dispozitën e nenit 12.2 të Ligjit të lartpërmendur përcaktohen procedurat ligjore që duhen zbatuar në raste të tilla për të konstatuar se në të vërtetë kemi të bëjmë me tepricë teknologjike, por, në rast konkret, e paditura as në gjykatën e shkallës së parë e as në procedurën e ankimimit nuk ka arritur ta argumentojë faktin se janë plotësuar kushtet e parashikuara nga dispozita e nenit 12.1 dhe 2 të Ligjit Themelor të Punës të Kosovës që paditësit t’ia shkëputë kontratën e punës, për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturore në ndërmarrje.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së parë, po ashtu, ka vlerësuar drejt se, në rastin konkret, nuk janë plotësuar kushtet ligjore që paditësit t’i shkëputet kontrata e punës në mënyrë të njëanshme dhe as në bazë të nenit 11.1 (d) dhe 11.4 të Ligjit Themelor të Punës të Kosovës, për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të rezultateve të punës, pasi që një konstatim i tillë është në kundërshtim me shkresat e lëndës, për faktin se nga shkresat e lëndës rezulton që, pas testimit të të gjithë stafit, midis tyre edhe të paditësit, ky i fundit ka treguar rezultate të suksesshme në testimin e zhvilluar, çka është vërtetuar edhe me deklaratën e ish-udhëheqësit të njësisë afariste të së paditurës në Ferizaj, N.D., i cili, përveç kësaj pozite, ka qenë edhe udhëheqës i grupit për testime, gjë që vërtetohet edhe nga shkresa e të paditurës të datës 13.09.2002, sipas së cilës, paditësi falënderohet për angazhimin dhe punën e tij shembullore të treguar gjatë kohës së punësimit të tij në ABK.

Prandaj, me të drejtë theksohet në revizion se gjykata e shkallës së dytë e ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vlerësuar se atij i është shkëputur kontrata e punës për shkak të skadimit të kohës së punësimit, për çka u desh që aktgjykimi i goditur të ndryshohet, duke marrë vendimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo Gjykatë tani për tani nuk mund ta pranojë si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sa i përket pjesës II të dispozitivit, që ka të bëjë me atë që paditësit t'i njihen të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, ngase, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale (neni 224.2 të LPK), gjendja faktike ka mbetur pa u vërtetuar drejt dhe, për këtë arsye, nuk ka kushte për ndryshimin e pjesës II të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, kështu që aktgjykimi në këtë pjesë u prishur dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë në këtë drejtim duhet të urdhërojë që paditësi ta precizojë kërkesëpadinë, të vërtetojë nëse gjatë kohës sa ka qenë jashtë marrëdhënies së punës ka punuar punë të tjera dhe ka realizuar të ardhura personale nga burimet të tjera dhe, pas vlerësimit të të gjitha provave veç e veç dhe të gjithave së bashku, të marrë vendim të ligshëm.

Në bazë të asaj që u tha më sipër dhe me zbatimin e nenit 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

REVnr.85/2016, më datë 22.3.2016

Kryetare e Kolegjit

Gyltene Sylejmani



